



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 12.2.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10416, DATË 7.4.2011, “PËR MATERIALIN MBJELLËS E SHUMËZUES BIMOR”, TË NDRYSHUAR”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës e shumëzues bimor”, të ndryshuar”, në mbledhjen e tij të datës 12 shkurt 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Ilir Ndraxhi.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës e shumëzues bimor”, të ndryshuar” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Ky projektligj vjen në kuadër të reformës së deregullimit, për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative. Gjithashtu, projektligji ndërhyr për të bërë përmirësime edhe për sa i përket laboratorëve që operojnë në këtë fushë.

Projektligji është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke u konsultuar me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe me Entin Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve.

Ndryshimet kryesore që sjell ky projektligj në legjislacionin ekzistues janë si më poshtë:

- projektligji propozon shfuqizimin e licencës “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve”, me kodin II.4. Me shfuqizimin e kësaj licence ushtrimi i veprimtarisë së prodhimit dhe/ose tregtimit të farave dhe fidanëve do të jetë i lirë, por kjo nuk do të pengojë punën e inspektorëve të AKU-së për të kontrolluar përmbushjen e kushteve që duhet të plotësojnë subjektet për përshtatshmërinë e ambienteve dhe mjediseve për përpunimin, paketimin, ruajtjen dhe tregtimin e farave, për të siguruar temperaturën dhe lagështirën optimale për ruajtjen e treguesve cilësorë dhe parametrave teknikë për farat.
- Gjithashtu, projektligji parashikon se prodhimi i kategorive të larta të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor bëhet nga furnizues publikë të autorizuar ose privatë të regjistruar në regjistrin tregtar (QKB).
- Përveç ndryshimeve që lidhen me kuadrin e deregullimit të lejeve e licencave, projektligji synon të bëjë disa përmirësime të nevojshme në fushën e analizimit të materialit mbjellës e shumëzues bimor në laboratorët e miratuar dhe atë të referencës për të vendosur në treg material mbjellës e shumëzues bimor me cilësinë e kërkuar. Ky ndryshim i siguron biznesit që importon material mbjellës e shumëzues bimor nga vendet e BE-së apo vendet që kanë nënshkruar marrëveshjen me UPOV-in (Unioni Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Varieteteve të Reja të Bimëve), kryerjen e analizave të besueshme dhe me cilësi, si dhe i siguron fermerët se materiali mbjellës e shumëzues bimor që vendoset në treg dhe që përdoret nga ata për mbjelljen e bimëve bujqësore është i cilësisë së kërkuar dhe se analizat e kryera janë të besueshme.
- Projektligji parashikon edhe përmirësimin e procedurës së marrjes së mostrave për kryerjen e analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimor. Kjo, pasi në praktikën e kryerjes së analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimor, inspektorët e AKU-së kanë hasur vështirësi lidhur me procedurën e marrjes së mostrave, përgatitjes dhe dërgimit të këtyre mostrave për analizë në laboratorin qendror të farave apo laboratorët rajonalë.

Projektligji do të sjellë një sërë përmirësimesh për subjektet që operojnë në këtë fushë si:

- Lehtësim nga procesi i licencimit për të operuar në këtë veprimtari. Tashmë kjo veprimtari është e liberalizuar dhe mjafton që këto subjekte të kenë të regjistruar në objektin e veprimtarisë në QKB prodhimin/tregtimin/importimin e materialit mbjellës e shumëzues bimor.
- Kryerjen e analizave laboratorike zyrtare të materialit mbjellës e shumëzues bimor në laboratorë të miratuar dhe atë të referencës në përputhje me standardet bashkëkohore;
- Miratimin e laboratorit të references, si laborator që vlerëson cilësinë dhe besueshmërinë e analizave të materialit mbjellës e shumëzues bimor nga laboratorët e miratuar;

- Përcaktimin e procedurave që ndiqen për marrjen e mostrave, lëvizjen e tyre, kryerjen e analizave dhe njoftimin e subjekteve për rezultatet e tyre;
- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 11 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Projektligji nuk përafron e nuk lidhet me asnjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Ky projektligj nuk ka ndikim në buxhetin e shtetit.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që ndryshimet që propozon projektligji do të ndikojnë në përmirësimin e klimës së biznesit në këtë veprimtari. Gjithashtu, për shkak të ndryshimeve të bëra në parashikimet që lidhen me laboratorët e referencës dhe akreditimin e tyre, do të rritet besueshmëria e fermerëve që materiali mbjellës e shumëzues bimor që vendoset në treg dhe që përdorin për mbjelljen e bimëve bujqësore është i cilësisë së kërkuar dhe se analizat e kryera janë të besueshme.

Përfaqësuesit e Ministrisë shpjeguan elementët kryesor që ky projektligj sjell, të cilët lidhen me reformën deregulluese për lejet dhe licencat, me rritjen e besueshmërisë për analizat e kryera, si dhe me krijimin e mundësisë së ngritjes së laboratorëve të akredituar në mënyrë që biznesi të ketë mundësi t'i kryejë në Shqipëri këto analiza.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në çështjet që lidhen me laboratorët e referencës, si dhe me mundësitë që do të krijonte akreditimi i tyre. Gjithashtu, u diskutua edhe për gjendjen aktuale të kësaj veprimtarie dhe plotësimin sa më optimal të pritshmërive të fermerit për materialin mbjellës e shumëzues bimor.

- ***Ndryshime të projektligjit***

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni vendosi që në tekstin e projektligjit të bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 1, pas pikës 2 të shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

3. Pas pikës 22 të shtohet pika 23 si më poshtë:

“23. “Analiza zyrtare” janë ato analiza që kërkohen nga institucionet e administratës shtetërore në përmbushje të funksioneve të tyre.”.

2. Në nenin 5, në pikën 3 që ndryshohet, fjalët “të specieve që ai importon” të hiqen.

3. Në nenin 7, në pikën 2, shkronja “c” që ndryshohet të riformulohet si më poshtë:

“c) propozon për ndalimin përkohësisht të ushtrimit të veprimtarisë së furnizuesit, nëse ky i fundit nuk ka të regjistruar në regjistrin tregtar objektin e veprimtarisë për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, deri në përmbushjen e këtij detyrimi, ose propozon ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së furnizuesit për rastet kur detyrat e lëna nga ai nuk janë zbatuar për më shumë se dy herë.”.

4. Në nenin 8 që ndryshon nenin 44, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

- a) Në fjalinë e parë të pikës 1, fjalët “përgjegjës për bujqësinë” të hiqen;
- b) Pika 3 të riformulohet si vijon: “3. Kriteret, që duhet të plotësojnë për t’u miratuar, laboratorët testues dhe laboratorët e referencës, si dhe procedura për miratimin e tyre, përcaktohen me udhëzim të ministrit.”;
- c) Në pikën 4, fjalët “që mbulon fushën e bujqësisë” të hiqen;
- d) Pika 5 të riformulohet si vijon: “5. Lista e analizave që kryejnë laboratorët e referencës miratohet me urdhër të ministrit dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.”.

• **Përfundim**

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për përmirësimet që do të sjellë në liberalizimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie, dhe për krijimin e një klime besueshmërie të shtuar tek fermeri shqiptar.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Ilir NDRAKHI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar